

VENDIM
Nr. 42, datë 13.6.2018

**PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS-
KANALIZIME KAVAJË SHA**

Në mbështetje të germës “h”, të pikës 1, të nenit 14, të nenit 15 dhe të nenit 32/1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe rregullores së inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 300 000 lekë, për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 100 000 lekë, për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

KRYETARI
Ndriçim Shani